



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:231454

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05569952

KF.nr.297/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarën Vera Gashi Bala, në konfliktin administrativ të paditësit NTL “Rilindja” me seli në Skenderaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Argjent Sefa kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit me nr.335/2021 datë 21.09.2021 për shkak të rivlerësimit tatimor, në seancën e shqyrtimin gjyqësor-kryesor publik, të mbajtur me datë 28.03.2024, në prani të autorizuarit të palës paditëse Argjent Sefa avokat, në mungesë të autorizuarit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses NTL “Rilindja” me seli në Skenderaj.
- II. ANULOHET vendimi nr.335/2021 datë 21.09.2021 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditëses NTL “Rilindja” me seli në Skenderaj t’ia kthej shumën e paguar të tatimit në shumën prej 13,108.22 euro për pagesat për tatimin e paguar, pagesat për ndëshkimin e paguar në vlerë prej 5,349.89 euro si dhe pagesat për interesin e paguar në shumë prej 5,421.27 euro, kthimin e kreditimit të TVSH në shumë prej 2,069.44 euro me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muajin kalendarik

në mes të datës së pagesës, e gjer në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në konflikt administrativ.

### A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 15.10.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, duke kërkuar anulimin e Aktvendimit nr. 335/2021 datë 21.09.2021, të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Përfaqësuesi i palës paditëse si në padi, në seancën kryesore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Mbesim pranë padisë dhe kërkesë padisë për anulimin e vendimit të DA të ATK-së nr. 335/21 i dt 21.09.2021. E paditura për këtë çështje administrative në ri procedure dhe rivendosje nuk ka vendosur drejtë dhe po ashtu nuk ka vepruar konform vërejtjeve dhe rekomandimeve të dhënë nga gjykata me aktgjykimin A.nr. 593/19 dt. 28.05.2021. Ne kemi pranuar përgjigjen në padi nga ana e gjykatës të cilën përgjigje në padi ne e kundërshtojmë në tërësi për shkak se e njëjta nuk jep fakte vendimtare për faturat të cilat nuk i janë pranuar paditësit me pretendimin se nga informatat e njesisë hetimore ka pasur dyshime për transaksione fiktive dhe duke u bazuar edhe në procesin gjyqësor me aktgjykimin që na u dha sot nga ana e gjykatës se kinse lëshuesi i faturave e ka pranuar fajësinë dhe është dënuar nga gjykata në procedurë penale. Mirëpo aktgjykimi nuk përmbanë fakte se për cilat fatura apo transaksione fiktive e ka pranuar fajësinë lëshuesi i faturave. Gjatë hetimit të bërë nga njësia hetimore të paditurës janë bërë të gjitha verifikimet e faturave andaj sikur faturat e paditësit të ishin fiktive apo do të kishte transaksion fiktiv atëherë ne do të kishim edhe në aktakuzë paditësin si bashkëkryerës mirëpo në rastin konkret lëshuesi i faturave mund të ketë lëshuar fatura për persona apo biznese tjera e të cilat nuk janë relevante për këtë procedurë. Paditësi me rastin e blerjes së mallit në vitin 2013 ka bërë verifikime në ëeb faqen e ATK-së ku ka vërejtur se lëshuesi i faturave NTSH Prishtina 2010 ka qenë i regjistruar , ka pasur numër fiskal, ka pasur numër të TVSH , andaj në bazë të këtyre të dhënave paditësi ka bërë transaksione duke blerë mallin për të cilin nga biznesi NTSH Prishtina 2010 janë lëshuar faturat paditësit, ku paditësi menjëherë ka bërë pagesat e këtyre faturave nëpërmjet

transaksionit bankar, të cilat dëshmi ia dorëzoi gjykatës. Po ashtu për mallin i cili është blerë nga ana e paditësit tek biznesi NTSH Prishtina 2010 iu ofrojmë dëshmi faturat e shitjes të cilat dëshmojnë se i njëjti mall është shitur tek institucione publike, Ministria e Punëve Publike, ministria e punëve të jashtme etj. me të cilat ka pasur kontratë për furnizim me material për zyre ku edhe i ofrojmë si dëshmi faturat e shitjes së mallit për institucionet publike. Në bazë të nenit 23 të Ligjit për ATK-në dhe procedurat e paditura bizneset të cilat i konsideron si delikumente ju anulon certifikatën e tvsh-së dhe të njëjtat i publikon në web faqen e saj ku në bazë të nenit 16 të UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit për ATK-në dhe procedurat par.3 thotë se ATK bënë publikimin e bizneseve të cilave i është anuluar certifikata e tvsh dhe në bazë të këtij neni të lartcekur nga data e publikimit nuk do të njihen shpenzimet apo transaksionet e lidhura me bizneset të cilat janë publikuar. Andaj në rastin konkret e paditura për anulimin e certifikatës së tvsh-së për biznesin NTSH Prishtina 2010 e ka bërë me datën 09.05.2014 ndërsa transaksione në mes të paditësit dhe NTSH Prishtina kanë ndodhur gjatë periudhës së vitit 2013. Andaj gjykatës si dëshmi i ofrojmë dëshmi nga web faqja e ATK e printuar me dt. 27.03.2024 për anulimin e certifikatës së tvsh-së. Lidhur me transaksionet apo me faturat e shitjes të biznesit NTSH Prishtina 2010 gjykata në një rast tjetër i ka njohur shitjet e tij për një biznes tjetër për periudhën e vitit 2013 si transaksione të rregullta. Si provë i ofrojmë aktgjykimin A.nr. 1111/2019 i dt 19.04.2022 i cili aktgjykim i shkallës së parë është bërë edhe i plotfuqishëm sepse për të njëjtën e paditura ATK nuk ka bere ankesë. Gjykatës gjithashtu si provës i dorëzoi pagesat e tatimit , ndëshkimeve dhe interesit të cilat kanë rrjedhur si rezultat i kontrollit nga ana e të paditurës. Pagesat për tatimin e paguar në shumën prej 13,108.22 euro, Pagesat për ndëshkimin e paguar në vlerë prej 5,349.89, Pagesat për interesin e paguar në shumë prej 5,421.27 euro , të cilat janë paguar të gjitha me datën 06.01.2020 për të cilat shuma kërkojmë që e paditura ti kthejmë me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.01.2020 datë kjo e pagesës së fundit për kryerjen e obligimeve. Andaj kërkojmë nga gjykata që paditësit ti a kthej shumën e paguar të tatimit në shumën prej Pagesat për tatimin e paguar në shumën prej 13,108.22 euro, Pagesat për ndëshkimin e paguar në vlerë prej 5,349.89, Pagesat për interesin e paguar në shumë prej 5,421.27 euro , të cilat janë paguar të gjitha me datën 06.01.2020 për të cilat shuma kërkojmë që e paditura ti kthejmë me kamatë ligjore prej 8% nga data 06.01.2020 datë kjo e pagesës së fundit për kryerjen e obligimeve, si dhe të bëjë kthimin e kreditimit të TVSH në shumë prej 2,069.44 euro.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 28.02.2023, e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, si të pa bazuar në ligj dhe fakte materiale dhe vlerëson se vendimi i kundërshtuar është i drejtë dhe në harmoni me legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, mbështetur në argumentet se i gjithë trajtimi dhe konstatimi nga ana e ATK-së është bazuar në provat të cilat janë të bashkangjitura nga numër 12 deri në 15 të kësaj përgjigje. Nëse i referohemi Raportit Final Hetues të datës 15.04.2019 i cili është përpiluar tek subjekti NTSH “Prishtina 2010” me të cilin paditësi ka marrë fatura dhe pretendon që ti njihen si të ligjshme, paraqitet në mënyrë të qartë se ky subjekt ka lëshuar fatura fiktive për paditësin . Edhe në deklaratimet e pronareve të subjektit ekonomik gjatë marrjes në pyetje të DHTI deklarohen se qëllimi i këtij biznesi është vetëm lëshimi i faturave fiktive dhe se nuk është që kanë funksionuar në ndonjë mënyrë të punës së rregullt biznese. Në bazë të këtyre deklaratimeve dhe në bazë të Raportit Final Hetues, Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritura Aktakuzën PP.II.nr.45/19 me të cilën a akuzuar pronaret e subjektit ekonomik NTSH “Prishtina 2010” se gjatë periudhës 2013-2014 kanë lëshuar fatura fiktive duke përdorur dokumente të falsifikuara. Mbështetur në dispozita ligjore , vërtetimin e gjendjes faktike të gjeturat dhe konstatimet e DHTI-së tek subjekti bashkëpunues me paditësin, provat e siguruara nga lënda gjyqësore P.nr.45/19 si dhe interpretimin e drejtë të dëshmive tjera si në shkresat e lëndës ATK-ja i propozon Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal që pas asministrimit të provave dhe analizimit të dispozitave ligjore relevante të merr Aktgjykim duke refuzuar si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit NTL “Rilindja” me adresë “28 Nëntori” pn Skenderaj dhe të mbetet në fuqi vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës – Divizioni i Ankesave Nr. 335/2021 i datës 21.09.2021.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ në bazë të nenit 41 të LKA-së në mungesë të palës së paditur, për arsye se, e paditura me parashtrësën e datës 21.03.2024 e ka njoftuar Gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë dhe ka kërkuar që të vepohet në pajtim me nenin 38 paragrafi 5 të LKA-së. (Provë; Parashtrësja e datës 21.03.2024 nga e paditura)

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 28.03.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi 335/21 dt. 21.09.2021, Aktgjykim A.nr. 519/2020, Aktgjykimi A.nr. 593/19, Përgjigja në padi e dt. 28.02.2023, Raporti i kontrollit dt. 24.10.2018, Vendimi 600/2018 i dt 07.02.2019, Vendimi

646/2018 i dt. 13.12.2018, Padi e dt. 08.03.2019, Faturat kontestuese me Prishtina 2010 së bashku me pagesat bankare, Gjendja bankare në Raiffeisen Bank dhe TEB Bank për paditësin, Libri i blerjes i paditësit për muajin janar 2013, Raport final hetues i dt. 15.04.2019, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit F.M. dt. 05.12.2017, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të të dyshuarit A.M. të datës 27.04.2018, Aktakuzë PP.II. nr.56/19, Procesverbal i shqyrtimit fillestar në lëndën P.nr. 2469/2019, Aktgjykimi A.nr 2469/2019 i dt. 01.03.2023, Transaksionet mes paditësit dhe institucioneve publike, gjithsej 39, Informatë për anulimin e certifikatës së TVSH-së printuar me datë 27.03.2024, Aktgjykimi A.nr. 1111/2019 dt. 14.02.2020, Pagesat për tatimet e paguara (14 pagesa).

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur me datë 15.03.2021 vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, në drejtim të thënieve në padi, thënieve në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë, dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për këto arsye:

Nga Raporti i Ri Kontrollit i Administratës Tatimore i datës 24.10.2018, Gjykata konstaton se paditura ka kryer vlerësim tatimor për paditësin pas kërkesës së të njëjtit për rimbursimin e TVSH-së. Objekt i vlerësimit tatimor kanë qenë periudhat dhe llojet të tatimeve TVSH-Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për periudhën 01/2013-12/2013, VM-Tatim të Mbajtur në Burim për periudhën 01/2013 deri 12/2013, CM-Kontribute Pensionale 01/2013 deri 12/2013, PD 2013 dhe CI 01/2013-12/2013 e i cili kontroll ka rezultuar me ulje kreditimit të TVSH-së që ka ardh si rezultat i mosnjohjes së faturave blerëse të lëshuara nga bizneset NTSH “Prishtina 2010” është ngarkuar me tatim bazë shtesë për pagesë në total prej 13,108.17 €, zvogëlim kreditimi të TVSH-së në shumë prej 2,069.44€ dhe eliminim ribmursimi për TAP në shumë prej 284.92€ sipas vlerësimit të kontrollit.

Gjykata konstaton se e paditura duke vepruar në ri procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.593/19 i datës 28.05.2021, me të cilin ishte aprovuar kërkesëpadia e këtu paditësit, ishte anuluar vendimi i Administratës Tatimore të Kosovës me nr.600/2018 i datës 07.02.2019, vendim ky me të cilin, në pikën e parë të dispozitivit të vendimit të kontestuar ka refuzuar ankesën e paditësit, në pikën e dytë të dispozitivit procedura e

ankesës nuk ndërprejnë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat. E paditura në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se tatimpaguesi ka pasur parregullsi në mbajtjen e regjistrimeve, respektivisht janë evidentuar parregullsi në Librin e Blerjeve si rezultat i mos pranimit të faturave të blerjes dhe biznesi “Prishtina 2010” mbi bazën e informatave nga Drejtoria e Hetimeve Tatimore DHT sipas të cilave transaksionet me biznesin në fjalë janë dyshuar se janë fiktive. Duke shpalosur pasqyrën e tatimpaguesit në ATK gjendjen e tatimpaguesit “Prishtina 2010” lexohet se nuk ka raportime blerjet mbi 500,00€ dhe shitje mbi 500,00€ gjithashtu tek Detajet e vlerësimit konfirmohet se dyshimet janë përmbushë sipas autorizimeve nga Drejtoria e Hetimeve Tatimore sipas të cilave transaksionet, si shitjet e tatueshme dhe blerjet e tatueshme janë vlerësuar me 0 tek subjekti “Prishtina 2010” pasi kanë konfirmuar dyshimin e arsyeshëm për transaksionet fiktive me këtë subjekt.

Tutje Gjykata konstaton se e paditura nuk ka aplikuar drejt dispozitat ligjore neni 37 paragrafi 2 i Ligjit 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, që parasheh: *Për të ushtruar të drejtën e tij për zbritje të TVSH-së së zbritshme, personi i tatueshëm duhet që së paku: 2.1. në lidhje me të gjitha zbritjet e referuara në Kapitullin e XIII të këtij ligji të mbajë një faturë ose një dokument që shërben si faturë në pajtueshmëri me Kapitullin XV të këtij ligji.* Gjykata vlerëson se të gjitha faturat e blerjes nga paditësi, kanë qenë të regjistruara në librat e blerjes, pagesat e tyre janë bërë përmes bankës, subjekti i cili i kanë lëshuar këto fatura kanë pasur çertifikata valide në kohën e lëshimit të tyre. Për më tepër, vet e paditura në vendimin kontestues e ka përdorur termin të dyshuara, se transaksionet me biznesin “Prishtina 2010” janë dyshuar se janë fiktive, andaj në këtë drejtim, gjykata vlerëson se nuk mund të cilësohen subjektet të dyshuara apo fiktive, ato subjekte përderisa kanë pasur certifikata valide të regjistrimit të biznesit, certifikatat e numrit fiskal të lëshuar nga vet e paditura, dhe kanë pasur certifikatat valide të TVSH-së të lëshuara, gjatë transaksioneve të blerjeve kontestuese.

Nga aktgjykimi i bashkangjitur njoftimit të të paditurës të datës 21.03.2024, gjykata konstaton se të akuzuarit A.M. dhe F.M. janë shpallur fajtor për veprën penale Dokumentet e rrejshme lidhur me tatimin nga neni 314 par 2 lidhur me par 1 e lidhur me nenin 31 dhe 81 të KPRK-së. Megjithatë, nga shkresat e lëndës nuk mund të konfirmohet nëse për paditësin ekziston ndonjë aktgjykim i formës së prerë se i njëjti i është shmangur tatimeve, aq më tepër kur nga shkresat e lëndës mund të konfirmohet

se malli i blerë i është shitur edhe institucioneve tjera e që konfirmohet me faturat në shkresat e lëndës të cilat edhe mbajnë shifrat e mallit kontestues.

Arsyetim i të paditurës është tërësisht i pa qëndrueshëm për gjykatën sepse paditësi nuk mund të mbajë përgjegjësi dhe të sanksionohet pse shitësit e furnizimeve të shërbimit ose mallit nuk i kanë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore, sepse përgjegjësi për deklarim dhe pagesë të tatimeve është e ndarë dhe ju përket vetëm personave përgjegjës të personave fizik, juridik, ortakërive të cilat ushtrojnë aktivitetet ekonomik sipas ligjit dhe kjo përcaktohet në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-222.

Gjykata konstaton se çështja e mos pranimit të shpenzimeve për tatim në të ardhura, apo kreditimit në TVSH është rregulluar me nenin 23 par.6 të UA nr.15/2010 për zbatimin e Ligjit nr.03/L-222 ku në mënyrë taksative është përcaktuar se *“Sikurse është paraparë në paragrafin 9 të Nenit 19 të Ligjit, nuk do të njihet asnjë shpenzim për qëllime të tatimit në të ardhura, apo qëllime të kreditimit në TVSh, si rezultat i transaksioneve me: 6.1.tatimpaguesit të cilët asnjëherë nuk janë regjistruar në ATK dhe nuk kanë numër fiskal; 6.2. tatimpaguesit të cilët janë çregjistruar në përputhje me dispozitat e Nenit 12 të këtij Udhëzimi Administrativ; 6.3. tatimpaguesit të cilët janë de-aktivizuar në përputhje me Nenin 13 të këtij Udhëzimi Administrativ; 6.4. bizneset të cilat janë regjistruar në ARBK, por nuk mund të gjenden në adresat e përdorura në atë regjistrim, apo çdo dokument regjistrimi të ofruar ATK-së, që rezulton në mos lëshimin e një numri fiskal; apo 6.5. tatimpaguesit të cilëve u është anuluar apo tërhequr certifikata e TVSh-së (lidhet vetëm me kreditimin e TVSh-së)”*. Ndërsa në paragrafin 7 të nenit 23 të UA nr.15/2010 është parashikuar se *“Data nga e cila shpenzimet nuk do të njihen për qëllime të tatimit në të ardhura, apo qëllime të kreditimit në TVSh, do të jetë ajo datë në të cilën ATK vendos në faqen e internetit njoftimin publik të faktit se transaksioni nuk do të njihet për shpenzime të tatimeve në të ardhura apo qëllime të kreditimit në TVSh. Njoftimi publik do të përmbajë një deklaram se transaksionet nuk do të njihen pas datës së specifikuar.”* Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohen asnjëri nga kushtet e parapara me paragrafin 6 të nenit 23, në mënyrë që paditësit të mos i pranohet TVSH-ja e zbritshme për faturat e blerjes nga subjekti i cekur më lartë, për arsye se subjekti “Prishtina 2010” ka qenë e regjistruar në ATK dhe ka pasur certifikata të TVSH-së, andaj gjykata nga shkresat e lëndës konstaton se ATK-ja këtij subjekti i’ a ka lëshuar numrat fiskal, dhe se

ia ka anuluar certifikatën e TVSH-së në periudhën kohore të mëvonshme, por jo para datës kur paditësi ka zhvilluar transaksione me këto subjekte.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit është plotësisht i bazuar dhe i drejtë dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore për njohjen edhe të shumës së mbetur nga periudha kontestuese tatimore për TVSH-ë, interesa dhe ndëshkime. Paditësi qysh në fazën e kontrollit por edhe gjatë fazës së ankimit ka paraqitur dokumentacion të harmonizuar për të dëshmuar pretendimet e tij si në padi, fakt ky jo kontestues, mirëpo e paditura nuk i ka marrë për bazë faturat dhe transaksionet bankare dhe në mënyrë krejt arbitrare ka obliguar paditësin më tatim shtesë por duke mos vërtetuar faktin se si ka ardhur deri tek një vlerësim i tillë, ashtu që pa bazë ligjore nuk i ka pranuar faturat dhe transaksionet e realizuara me subjektin “Prishtina 2010” i cili subjekt ka poseduar certifikatë të vlefshme në periudhën e lëshimit të faturave kontestuese, e paditura në këtë rast ka konstatuar gabimisht gjendje tjetër faktike. Prandaj, Gjkata duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 81, par 2, nën par 2.2 të ligjit nr.04/L-102 dhe nenit 46 par.5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative e miratoj kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroj të paditurën që paditësit t’ia kthej shumën e paguar më tepër në emër të ndëshkimeve dhe interesit për periudhën kontestuese.

Prandaj në bazë të gjendjes faktike të konstatuar më lartë, ballafaqimit të provave në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të vendimit kontestues, gjykata vlerësoi se organi i paditur ATK-së ka nxjerr konkluzion jo të drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike lidhur me transaksionet e faturave tatimore për periudhën 01.01.2013-31.12.2013, gjykata ka vendosur vetë në këtë konflikt administrativ ashtu që ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar vendimin nr.335/2021 i datës 21.09.2021 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, duke e obliguar të paditurën Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, që paditësit NTL “Rilindja” me seli në Skenderaj, t’ia kthej shumën e paguar të tatimit në shumën prej pagesat për tatimin e paguar në shumën prej 13,108.22 euro, pagesat për ndëshkimin e paguar në vlerë prej 5,349.89 euro si dhe pagesat për ineteresin e paguar në shumë prej 5,421.27 euro, kthimin e kreditimit të TVSH në shumë prej 2,069.44 euro me me kamatë ligjore në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, në lidhje me secilin muajin kalendarik në mes të datës së pagesës, e gjer në pagesën definitive, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi.



Rrjedhimisht, Gjykata konform nenit 46 par 4 të LKA-së me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar,”* vendosi që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa vendimin lidhur me obligimin si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi me të cilin e paditura obligohet të kthej mjetet e paguara nga paditësi e mori konform nenit 46 par 5 të LKA-së, me të cilin përcaktohet se *“Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore.”*

Vendimi mbi kamatë në shumën e obliguar si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 82 par.4 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, ku është paraparë se *“Në qoftë se lënda për të cilën është bërë ankesë, është zgjidhur përfundimisht në favor të tatimpaguesit, ATK do t'i kthejë çdo tatim të paguar tepër, së bashku me interesin e llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave në lidhje me secilin muaj kalendarik në mes të datës së pagesës nga tatimpaguesi dhe datën kur ATK i referon për pagesë rimbursimin Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”*.

Gjykata konform nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative me të cilin shprehimisht përcaktohet se në procedurën e konfliktit administrativ secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale, vendosi si në pikën IV të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:231454  
Datë: 12.04.2024  
Numri i dokumentit: 05569952

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.297/22 datë 28.03.2024

Gj y q t a r ja,  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.